

2024
16/1

I nderuar z.Matlilja!

Në vijim të kërkesës Tuaj në lidhje me numrin i ankesave të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit për shkeljen e të drejtës për informim për vitin 2023, duhet tju informojme se:

Me krijimin e institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ketij institucioni i janë atribuar që nga viti 2008 e në vazhdim kompetenca të drejtëpërdrejta dhe të qarta në trajtimin tërësor të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit rregullator që sanksionon dhe mbron këto të drejta themelore, duke filluar që nga trajtimi i ankesave individuale që lidhen me këtë fushë të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe deri tek kontrolli sistemik i saj.

Në një situatë të tillë, qasja e ofruar nga të dyja institucionet, ka qenë pikërisht lidhja e një marrëveshje e bashkëpunimi, me qëllim dhe përcaktimin dhe zgjidhjen e një konflikti të mundshëm kompetencash në këtë kuptim.

Mbi bazën e kësaj marrëveshjeje institucionale, institucioni i Avokatit të Popullit ka qartësuar rolin e tij të padiskutueshëm në kuadër të promovimit të standardeve më të larta, të aplikimit të së drejtës për informim në vendin tonë, si dhe të ndërhyrjeve të mundshme që lidhen me përmirësimin apo ndryshimin e sistemit të normave rregullatore, të regjimit juridik të së drejtës për informim, në Shqipëri.

Ndërkohë, trajtimi i ankesave individuale që futen nën regjimin juridik të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i kalohen për shqyrtim kompetencial automatikisht Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin